



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti  
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë e Rregullt e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

**Datë:** 16 janar 2026.

**Filloi në ora:** 10:00.

**Vendi:** Salla për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në “Shtëpinë e Bardhë” - Prizren.

**Në mbledhje morën pjesë këta anëtarë të Kuvendit të Komunës:** Simir Krasniqi – Kryesues, Adem Shabanaj, Adrit Krasniqi, Agim Muqaj, Agnesa Sinanaj Gavazaj, Alban Bislimej, Albulena Balaj Halimaj, Arianit Berisha, Astrit Temaj, Dafina Alishani, Daut Panikaj, Dea Gavazaj, Drita Qenaj, Driton Sallauka, Dzenkis Saliji, Eldis Abazi, Endrit Zogaj, Furkan Bütüçi, Haziz Hodaj, Ilir Gashi, Karanfil Haxhillari, Liridona Veçgishi, Mergiton Gavazaj, Mimoza Memaj, Nazife Kokollari, Nerimane Pllana Gashi, Petrit Hoxhaj, Qemal Krasniqi, Sefidin Islamaj, Selman Sokolaj, Sevil Kazazi, Sevilja Igeci Hapçi, Shqipe Shatri Çoçaj, Shukri Quni, Sulltan Badalli, Tefik Tarashaj, Trëndelina Kastrati, Ymran Fusha, Zgjim Kryeziu, Zikreta Aliti.

**Pjesëmarrës të tjerë ishin:** Kryetari i Komunës z. Shaqir Totaj, Nënkryetari i Komunës z. Kujtim Gashi, drejtorët e Drejtorive komunale, zyrtarë komunal, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Simir Krasniqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** A jemi gati? A mund të fillojmë? Përshëndetje i nderuar Kryetar i Komunës zoti Shaqir Totaj. I nderuar nënkryetar zoti Gashi, të nderuar drejtor të ekzekutivit, përfaqësues të mediave, shoqërisë civile, të nderuar dhe shumë të respektuar kuvendarë. Ju përshëndes të gjithëve. Së pari pra dua t'ia uroj detyrën drejtorëve të zgjedhur. Ju uroj shëndet, punë të mbarë dhe të gjithëve ju priftë e mbara. Për sot, siç jeni njoftuar me kohë kemi thirrur mbledhjen e parë të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2026. Të pranishëm jemi 34 anëtarë, kemi kuorum për të vazhduar këtë seancë. Ju informoj se pas thirrjes së mbledhjes disa nga anëtarët e Kuvendit Komunal kanë dhënë dorëheqjen nga anëtari i kuvendit. KQZ-ja, ka marrë vendim për zëvendësimin e tyre. Konsideroj që anëtarët e rinj janë prezentë në sallë dhe pa humbur kohë do t'i lexoj një nga një vendimet e KQZ-së dhe pastaj ftoj anëtarët e rinj që të bëjnë betimin solemn para anëtarëve të kuvendit.

1. Në bazë të vendimit të KQZ-së me nr.01/09-2026 të datës 08.01.2026 për emërimin e anëtarit të kuvendit komunal, z.Daut Panikaj emërohet anëtar i kuvendit komunal nga PDK, duke e zëvendësuar z.Islam Ukaj.
2. Në bazë të vendimit të KQZ-së me nr.01/10-2026 të datës 08.01.2026 për emërimin e anëtarit të kuvendit komunal, z.Sulltan Badalli emërohet anëtar i kuvendit komunal nga PDK, duke e zëvendësuar z.Adem Morina.
3. Në bazë të vendimit të KQZ-së me nr.01/11-2026 të datës 08.01.2026 për emërimin e anëtarit të kuvendit komunal, znj. Trëndelina Kastrati emërohet anëtare e kuvendit komunal nga PDK, duke e zëvendësuar znj. Luljeta Veselaj Gutaj.
4. Në bazë të vendimit të KQZ-së me nr.01/38-2026 të datës 12.01.2026 për emërimin e anëtarit të kuvendit komunal, z.Adrit Krasniqi emërohet anëtar i kuvendit komunal nga PDK, duke e zëvendësuar z.Bexhat Bytyqi.

Ftoj anëtarët e rinj të Kuvendit Komunal të ngrihen në këmbë për të dhënë betimin. Betimi lexohet pjesë pjesë nga unë, Kryesuesi i Kuvendit dhe përsëritet nga ju. Pas fjalës unë, secili thotë emrin dhe mbiemrin e vet.

Unë, \_\_\_\_\_, “beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mija si anëtar i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

*(Anëtarët e rinj dhanë betimin dhe nënshkruajtën deklaratën nën betim).*

Urime, suksese ju priftë e mbara. Kërkojmë nga ju që pas dhënies së betimit t'i nënshkruani formularët dhe deklaratën nën betim.

Atëherë, fillojmë me rendin e ditës të përgatitur për ditën e sot. I japim fjalën Kryetarit të Komunës.

**Shaqir Totaj (Kryetar Komune):** Të nderuar të pranishëm, unë e kam veç një përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po më së shumti për asamblistët, të cilëve të gjithëve ju uroj zgjedhjen në

postin e asamblistit pa dallim partie, gjithashtu drejtorëve e sidomos atyre që janë zgjedhur risht, ju uroj mandatin e ri dhe jam shumë e sigurt se me kontributin e secilit nga ne, katërvjeçari i ardhshëm do të jetë i suksesshëm në drejtim të plotësisht të nevojave dhe përmirësimit të kualitetit të jetës për të gjithë qytetarët e Prizrenit. Dua me ju falënderuar secilin, ata që kanë qenë mandatin e kaluar për kontributin që e keni dhënë edhe me një besim të plotë se ky mandat do të jetë hala më i suksesshëm. Ju falënderoj të gjithëve.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit kryetar. Atëherë fillojmë me rendin e ditës të përgatitur për ditën e sotme, ku kjo seancë do t'i ketë shtatë pika.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Inauguruese të datës 10.12.2025, si dhe mbledhjes së Jashtëzakonshme të datës 24.12.2025;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2026.

### **1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Inauguruese të datës 10.12.2025, si dhe mbledhjes së Jashtëzakonshme të datës 24.12.2025;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Vazhdojmë pra me pikën e parë. Paraprakisht te procesverbalet kisha kërkuar nga anëtarët që sapo dhanë betimin, edhe pse tash kanë të drejtë vote, të mos votojnë fare për procesverbalet, meqë nuk kanë qenë anëtarë të kuvendit kur janë mbajtur këto dy mbledhje. Atëherë, kërkoj nga ju a keni me shtu rreth procesverbaleve diçka? Gjithsej janë 40 të pranishëm. Kush është?

Për: 36

Kundër: 0

Abstenim: 0

Pra, miratohen procesverbalet.

## 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Kalojmë në pikën e dytë. Po, Haziz Hodaj.

**Haziz Hodaj (LDK):** Faleminderit kryesues. Faleminderit për fjalën edhe për ndërhyrjen e rendin e ditës. Përshëndetje për kryetarin, për nënkryetarin, drejtorët e rinj. Urime edhe njëherë dhe ju shkoftë puna mbarë, anëtarët e kuvendit, median edhe të gjithë mysafirët që janë prezent në sallë. Unë e di që ekziston një komision i krizave apo emergjencave, por ajo që ka ndodhur para një jave, para 10 dite me vërshime të mëdha, e do një përkujdesje të veçantë. Ajo ka qenë një gjendje apokaliptike, një gjendje jashtëzakonisht e rëndë që ka shkaktuar shumë dëme, për fat të mirë jo në njerëz. Andaj do të kërkoj që të futet në rendin e ditës edhe një pikë për ta formuar një komision që do ta udhëheqë vetë Kryetari i Komunës, me u marrë seriozisht me vlerësimin e dëmeve që kanë ndodhur sidomos në anën e Përdrinisë andej edhe të Hasit. Unë e di që buxheti i komunës nuk mjafton apo nuk është i mjaftueshëm për t'i kompensuar këto dëme, mirëpo ajo çfarë është e jona, ne mundemi me vlerësu mirë dhe drejtë edhe jo me u bazu shumë në kërkesa sepse jo të gjithë kanë mundur me bë kërkesa dhe kanë pasur informacione që të bëjnë kërkesa për vlerësim. Kështu që është mirë që të hulumtohen të gjitha ato dëme që janë bërë, të evidentohen dhe t'i dërgohen natyrisht Ministrisë të linjës për kompensim. Faleminderit.

**Shaqir Totaj (Kryetar Komune):** E falënderoj Hazizin për këtë çështje që e ngriti, që është shumë e rëndësishme, por nuk e di a je i informuar që ekziston një komision i tillë.

**Haziz Hodaj (LDK):** Unë e thashë në fillim që e di që ekziston, mirëpo kjo do një kujdes të veçantë. Sepse komisioni që është i formuar, është i formuar më herët edhe nuk e di a është i kompletuar, por do të duhej që qeveria e re komunale, merrej seriozisht me këtë punë. Tash i ke edhe drejtorët e rinj këtu për me punu, sigurisht që janë të gatshëm me dhënë kontribut të secili nga ata për me vlerësuar mirë dhe drejt këtë dëm që është bërë.

**Shaqir Totaj (Kryetar Komune):** Prej drejtorëve Fatmiri nuk është bashkë i ri, po nejse. Përndryshe po pajtohem plotësisht po ne e kemi pasur, e kemi komisionin edhe komisioni natyrisht që ka qasje serioze, po në qoftë se shumica mendon që duhet edhe asambleja me votu për ato, unë nuk jam kundër asaj, veç komisioni ekziston, po kemi prit që gjendja me u qetësu pak edhe pastaj me fillu punën për me evidentu cilat janë dëmet, aq sa mundem na në mënyrë precize me bë edhe pastaj me shiku se ka duhet me i adresu ato, kush ka resurse, kush ka kapacitete, e ne e dimë që komuna ka shumë pak resurse dhe kapacitete, qeveria qendrore po du me besu që do të kyqen për me kompenzu dëmet për aq sa do të ketë mundësi, sepse nevojat janë evidente. Por gjithsesi, në qoftë se shumica mendon që duhet me fut si pikë në rendin e ditës, unë jam në rregull. Kështu që të falënderoj për këtë çështje që e ngrite.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit kryetar. Fjalën ja japim Dafin Alishanit.

**Dafina Alishani (LVV):** Faleminderit kryesues, vetëm deshta të informohem a jemi në rend të ditës apo propozohet me u fut në rend ditës apo po diskutojmë këtu, ju lutem, na informoni. A ka

propozim direkt me u fut në rend ditës, ndonjë buxhet, ndonjë linje, apo për çka jemi tu diskutu? Ende nuk kemi fillu seancën edhe fillojmë diskutime të tilla.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit Dafin. Jemi në rend të ditës, në bazë të rregullores së punës së Kuvendit, në rend të ditës kuvendarët e kanë të drejtën të propozojnë pika.

**Dafina Alishani (LVV):** Po po, saktë. Po çka është propozimi, a mundemi me pas si propozim të rendit ditës.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Tash, Haziz kështu, në qoftë se një komision ekziston, unë nuk e kisha parë të arsyeshme që këtë komision ta fusim në rend ditës. Komisioni ekziston, është komisioni edhe ai do ta kryejë punën e vetë si është më së miri.

**Haziz Hodaj (LDK):** Për sqarim. Unë isha shumë i qartë. Ndërhyrja ke në pikën është shqyrtimi i rendit të ditës dhe kërkova që me e fut në rend të ditës formimin e një komisioni që do të merret me krizën që është shkaktuar këto ditë nga vërshimet. Kaq. Natyrisht që kur e bëj propozimin e bëj edhe arsyetimin pse! Edhe nuk pat asnjë diskutim tjetër këtu përveç një kërkese konkrete.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Është kështu, kur komisioni ekziston, është vendimi, ai vendim duhet të shfuqizohet, personat janë dhe tha kryetari që do të merren me këtë çështje, me atë komision ata do të dalin në terren dhe do të verifikojnë rastet ku do të ketë nevojë më së shumti në cilat rajone. Atëherë, fjalën e ka Shukri Çuni.

**Shukri Quni (BDP):** Faleminderit, kryesues. Përshëndetje kryetar, kolegë kuvendar, përshëndetje për të gjithë të pranishëm. Unë e di që çdo komision votohet këtu. Ky është tash kuvend i ri. Domethënë legjislativ i ri. Çdo komision që formojmë ne kemi me votu këtu. Unë edhe unë kam pasur me propozu, po Hazizi propozoi para meje që e mbështes edhe unë fuqimisht për formimin apo themelimin e një komisioni të përhershëm, për vlerësim të dëmeve edhe vërshimeve që janë bërë domethënë nga katastrofa natyrore. Nëse qe ky komision është themeluar, është themeluar në mandatin e kaluar, nëse unë munde me kuptu. Na duhet si kuvend këtu me themelu një komision i cili do të merret me vlerësimin e dëmeve të rinj. Qata anëtarë që kanë qenë prej këtij kuvendi tash disa nuk janë. Pa marrë parasysh se kush është zgjedhur. E ky komision edhe unë kërkoj që të futet në rend dite edhe të themelohet. Pa marrë parasysh kush merr pjesë ose kush futet në atë komision. Shumë ke i qartë edhe kolegu, po edhe unë e mbështes që të themelohet ky komision.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit. Qemal Krasniqi e ka fjalën.

**Qemal Krasniqi (LDK):** Faleminderit, përshëndetje për të gjithë. Unë sa e di, ky komision në vitet e kaluara ka qenë i përbërë prej drejtorive. Secila drejtori ka pasur përfaqësuesin e vetë në komision. Asnjë anëtar i kuvendit nuk ka qenë i përfshirë në këtë komision. Unë sa di. Po shtrohet pyetja, a kishte pasur mundësi që në atë komision edhe dy tre anëtarë të kuvendit të hyjnë. Dhe a parasheh rregullorja, a parasheh ligji këtë gjë? Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Fjalën ja japim nënkryetarit të komunës, zotit Kujtim Gashi.

**Kujtim Gashi (Nënkryetar Komune):** Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, drejtor, anëtar të kuvendit. E para, nuk desha me marrë fjalën, veç meqë është hapur tema dhe po diskutohet. Siç e dini, rasti i vërshimeve dhe fatkeqësive natyrore nuk trajtohet prej kuvendit. Trajtohet prej njerëzve që janë ekspertë. Ekspertë kanë drejtoritë edhe ky komision ekziston. Është duke mbledhur materiale, është duke mbledhur kërkesa nga qytetarët, nga banorët. Kanë qenë vizita në secilin lokalitet. Drejtorja e emergjencave e ka drejtuar këtë farë procesi edhe nuk e di cili është efekti i themelimit të një komisioni prej anëtarëve të kuvendit, që asnjëri këtu nuk është ekspert i emergjencave. Nëse doni me bë politikë në rregull po ky komision ekziston, është duke kryer punën e vetë, ka me përmbledhur me një raport dhe raportin ka me dërguar në qeverinë e Republikës Kosovës.

**Zikreta Aliti (NDS):** Të nderuar të gjithë të pranishëm, si asambleiste e partisë NDS ju paralajmëroj që në takimet e fshehta janë pajtuar për vendin e nënkryetarit për komunitete të dorëzohet komunitetit turk. Me këtë drejt për drejt shkelet neni 3, neni 57 paragraf 2, neni 61 si dhe neni 62 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës por edhe neni 6 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i cili qartësisht parashikon emërimin e komuniteteve dhe kërkon nga asambleistët tjerë boshnjakë mos të votojnë këto.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Zonjë, është rendi i ditës. Edhe duhet ta respektoni rregulloren e Kuvendit edhe minutazhin. Jemi në rendin e ditës. Vazhdojmë pra me rendin e ditës. Hedhim në votim. Kush është për?

**Dafina Alishani (LVV):** Veç pak, veç pak, një minutë, kadale, kadale. Kryesues, nuk je tu ja nis mirë. Më fal. Kërkesa e zonjës ke me heq një pikë të rendit të ditës, kërkesa e zotërive ke me shtu rendin e ditës. Tash nëse del nënkryetari edhe thotë ka komision, atëherë po i heqet e drejta e kuvendarit me propozu në rendit të ditës pikë. Hedhet në votim secila kërkesë e secilit asambleist. Qashtu ka qenë praktika, të lutna si kryesues i ri, përmbaju edhe po të lutna kushdo që thotë prej ekzekutivit ndalja fjalën, mos i ngo. Ti je kryesues, ti i din rregullat edhe po fillojmë me start më mirë.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit pra Dafinë, atëherë erdhëm në votim rendin e ditës.

**Haziz Hodaj (LDK):** Kryesues, edhe njëherë. Edhe njëherë. Se nuk ka nevojë as Dafina as kërkush një pikë që e propozoj vetë, vetë e arsyetoj edhe vetë e heqim mandej arsyetimin apo propozimin. Unë u nuk e di cili është ai komision dhe kujt i jep llogari. Unë e di që ekziston një komision. Thashë edhe në fillim, që në fillim e ceka. Që kjo gjendje e krijume e kërkon një komision shumë urgjent, shumë të shpejtë që me vepru shpejt. Qekjo është kërkesa ime. Përndryshe komisioni që është, le të punon, le ta kryej punën e vet. Mirëpo është mirë ai komision me i dhënë llogari këtij kuvendi. Përveç ekzekutivit apo kryetarit të komunës që jep. Me ja dhënë një raport. Që kjo ke kërkesa, me e bë një komision, që do të merrej urgjentisht me gjendjen e krijuar mbas shirave.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Në qoftë se komisioni është, edhe tash vendimi është, ai komision, ju si kuvendar, e keni atë të drejtën që të kërkon raportim ndaj çdo komisioni, jo vetëm ndaj këtij komisioni. Tash është edhe si pikë e rendit të ditës pra, për ku do të bëhet plani dhe programi i kuvendit të komunës, mund të futet të gjitha komisionet të raportojnë para kuvendit.

**Kujtim Gashi (Nënkryetar):** Nëse ka mundësi veç një shërim se është krijuar një farë paqartësie. Komisioni është i ri Haziz, tash është formuar. Krejt drejtoritë i kanë anëtarët e vet i kanë deleguar në këtë komision. Është duke i mbledhur kërkesat, ka dalë në vizita, i ka vizituar. Po ta prezantojmë ma vonë, s'e kam në xhep tash. Po komisionet për raste të tilla i formon kryetari i komunës. Është kompetenca ekskluzive me ligjin për vetëqeverisjen lokale. Ky komision ekziston. Nuk e di çfarë komisioni po kërkon. I njëjti komision, veç pak ta kryej Haziz, se paske energji sot. I njëjti komision raportin e bjer në kuvend. Kuvendi e miraton raportin dhe ai raport shkon në qeverinë e Republikës së Kosovës, gjithmonë ka qenë kështu. Nëse keni harruar, s'po di çfarë me thënë.

**Haziz Hodaj (LDK):** Okej, atëherë unë po kërkoj që në seancën tjetër, që ai komision me na dalë me një raport konkret, me raportu para kuvendit. Faleminderit.

**Selman Sokolaj (LVV):** Faleminderit kryesues. Sa i përket të parës, në bazë të ligjit për vetëqeverisjen lokale, që kompetencat e kryetarit, kompetencat e komunës, kryetari me propozim mundet me propozuar një komision të veçantë në raste të veçanta, për shkak se ka komisione të rregullta për shkak të zjarreve, dëmeve të ndryshme që i shkaktohen qytetarëve, edhe në këtë rast jemi para një shtate, një vërshimi që potencialisht ndodh më rrallë. Kështu që ligjërisht, përfaqësuesi ligjor mundet me na e sqaru, ligjërisht kemi mundësi me propozim të kryetarit me formuar një komision të veçantë, që e bën vlerësimin e dhe analizën e dëmeve dhe e dërgon në institucionet përkatëse, përkatësisht në agjencinë e menaxhimit të emergjencave dhe ai e bën pagesën ose shpagimin e dëmeve që ka ndodhur. E dyta, jemi te pikat e rendit të ditës. Zonja më herët ke shumë e qartë. Çka ka ndryshuar nga kuadri ligjor, përveçse ndonjë pazari që kryetari është pajtuar që me zgjedhur përfaqësuesin e komiteteve si nënkryetar të komunës, nënkryetarin nga komunitetet. Kështu që, ajo kërkoj heqjen e kësaj pike nga rendi i ditës edhe ju si kryesues pasi jemi të rendit i ditës e keni obligim me hedhur në votim. A hiqet apo nuk hiqet vendosin kuvendarët këtu me shumicë votash. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Te pika për zgjedhjen e nënkryetarit për komunitete, nuk ka ndryshuar kurrëgjë. Ligji për vetëqeverisje lokale e obligon kryetarin ku 10% të komunitetit pakicë janë në atë komunë duhet ta zgjedh brenda 30 ditë. Dhe kjo pikë nuk hedhet në votim.

**Selman Sokolaj (LVV):** 4 vite nuk e keni zgjedh kryesues në mandatin e kaluar. Kjo është pikë e rendit të ditës. Kuvendarët vendosin kush rri në pikë të rendit ditës edhe kush hiqet. Ju doni me e qit në votim. Edhe kuvendarët vendosin, as ju, as Kujtim Gashi që po ta udhëheqë seancën me fillim.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Ne nuk mundem me vepruar me dalë jashtë ligjit për vetëqeverisjen lokale. Ligji e obligon kryetarin që ta emërojë nënkryetarin për komunitete dhe atë brenda 30 ditëve.

**Dafina Alishani (LVV):** Më fal veç pak. Ligji thotë kryetari e propozon. Votimi bëhet në kuvend. Po në rregull, po a po e dëgjoni kryesuesin çfarë thotë? Propozimi vjen nga kryetari. Votimi bëhet nga legjislativi. Dallojeni bre mua këto sende se i keni do vite eksperiencë këtu.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Dafina, e drejta juaj është hedhet në votim. Së pari e shumë e voton shumica, mandej pakica prej komunitetit, e keni të drejtën e votës, që doni e votoni, që nuk doni e drejt juaj është e kuvendarëve.

**Karanfil Haxhillari (LVV):** Kryesues, e ke një propozim konkret nga një komunitet. Thotë me heq pikën e rendit ditës, sepse jemi në pikë të rendit ditës. Dhe në këtë rast si kryesues e hedh në votim. A me u heq a mos me u heq? Shumë e thjeshtë është. S'di pse po komplikojmë një diçka që non-stop është bërë.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Atëherë, e hedhim votim pra shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e nënkryetarit të komunës për komunitete. Kush është për që ta largojmë këtë pikën e rendit të ditës? 15 për. Kush është kundër? 22 kundër. Abstenim 0. Kjo pikë mbetet në rendin e ditës.

## **2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** E hedhim në votim rendin e ditës. Kush është për këtë rendin e ditës?

Për: 25

Kundër: 0

Abstenim: 0

Miratohet rendi i ditës me këto shtatë pika të rendit të ditës në këtë seancë.

## **3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Kalojmë pra te pika e tretë. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme. A do dikush me marrë fjalën?

**Qemal Krasniqi (LDK):** Faleminderit. Pak më herët veç është diskutuar problematika e këtyre ditëve, domethënë vërshimet që kanë ndodhur në territorin e komunës së Prizrenit e posaçërisht në Përdrini, nga pjesa e Hasit dhe një pjesë e Zhupës. Është fakt se këto të reshurat e fundit kanë sjellë shumë dëme si në amvisëri, ashtu në bujqësi po edhe në infrastrukturë. Meqënëse, pak më herët është diskutuar kjo, unë nuk do ta zgjasësh shumë, po kisha bërë thirrje që ai komision të del në vend të ngjarjes, në çdo lokalitet veç e veç, në çdo familje, aty ku është krijuar dëmi, ku është bërë

dëmi dhe aty në atë infrastrukturë ku është dëmtuar, bëj thirrje organeve kompetente, përkatësisht drejtorive, të cilat marrin masa që t'i sanojnë ato, ato dëme. Kaq kisha, faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Zoti Qemal, fjalën e ka Shqipe Shatri.

**Shqipe Shatri (LVV):** Faleminderit kryesues zotëri Krasniqi. Pa humbur kohë ju drejtohem drejtorisë së shërbimeve publike. I nderuar drejtor zotëri Ukimeri, sefte edhe me këmbë të mbarë. Duke qenë se vij nga rajoni i Hasit, unë si zakonisht kërkesat e para i parashtroj për vendin nga vij. Kërkoj nga ana juaj shqyrtimin dhe ndërmarrjen e veprimeve për rregullimin e urës në fshatin Kushnin të Hasit, e cila gjendet përballë mullirit të vjetër. Gjendja aktuale e urës vërtet është ka vështirësi dhe paraqet vështirësi për qarkullim për të gjithë udhëtarët që i bien asaj ane. Prandaj, ndërhyrja është e domosdoshme dhe mendoj që është më së urgjente. Ndërsa, ngritja e çështjes së dytë është lidhur me fshatin Kabash i Hasit, i cili në vazhdimësi fatkeqësisht është lënë pas dore nga institucionet komunale. Ekziston nevojë urgjente për rregullimin e shtratit të gurës dhe të urës së vetme në hyrje të fshatit. Sa herë që ka reshje shiu, kalimi bëhet i pamundur dhe faktikisht fshati mbetet praktikisht i izoluar. Kërkoj nga drejtoria juaj që ta shqyrtoni pozitivisht këtë kërkesë, ngase është vërtetë e nevojshme. Sepse fshati Kabash dhe Kushnin i Hasit nuk mund të trajtohen më si periferi të harruara nga drejtoritë komunale. Faleminderit, duke pasur minutazhin në dispozicion e shfrytëzoj rastin për drejtorinë komunale të arsimit, kërkesën e radhës. Shumë e nderuar drejtoreshë, zonja Veselaj Gutaj, duke qenë se punoj në shkollën e Gjonaj, po e shfrytëzoj këtë mbledhje për ta ngritur drejtpërdrejtë një shqetësim që na përcjell çdo vit. Aktualisht objekti shkollor në Gjonaj i naltë funksionon me sistem ngrohje me dru, i cili gjatë stinës së dimrit na shkakton vështirësi të vazhdueshme dhe nuk arrin t'i plotësoj nevojat për ngrohje. Për këtë arsye ju kisha lutur që të planifikohet ndërrimi i kalldanjave dhe të shqyrtohet mundësia e kalimit në një sistem më efikas si ngrohje me pelet ose edhe me rrymë. Sepse gjatë dimrit mungesa e ngrohjes adekuate po ndikon drejtpërdrejtë në procesin mësimorë dhe në mirëqenien e nxënësve. Ju faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit zonja Shatri. Ka dikush tjetër me diskutu? Atëherë fjalën e ka Shukri Quni.

**Shukri Quni (BDP):** Faleminderit kryesues. Shfrytëzoj rastin t'i ju uroj punë mbarë kuvendarëve të rinjtë cilët sot dhanë betimin, po ashtu dhe ekzekutivët. Shpresoj që do t'i përcjellin kërkesat tona dhe çështjet që do t'i ngrisin. Një propozim që e dha më herët kuvendari Haziz Hodaj, unë me të vërtetë pata me propozu vetë. Kam një propozim për kryetarin dhe për kuvendin, jo për drejtorët. Që themelohet një komision i përhershëm për vlerësimin e dëmeve. Është fjala katastrofat natyrale, vërshimet. Nga ky kuvend. Ne me votu sikur që i votojmë edhe komisionet tjera që janë. Mos i ceket tash komisioni për arsim, komisioni për emërtim të rrugëve. Unë kështu kam pasur me bëj kërkesën edhe në fakt po e bëj prap, po e ngris si çështje. Drejtor, urime i shërbimeve publike je ul pikërisht në vendin e kolegut, ish-kolegut tonë Qel Lamaj. Ke qenë drejtor i inspektorateve. E kam ngritur shumë herë çështjen, bile shumë do kolegë këtu, ju vijke pak si nerva kur e cekesha rrugën për Nashec, ke qenë drejtor i inspektoriateve. 14 herë është prej sa ke qenë drejtor ti rruga.

Po kesh po, realiteti është ky. S ke mujt me ndiku. Rruga ka trotuar në dy anët. S'ka pas nevojë me u pre ajo se është pre si në formë inati. Po a di çka po të propozoj tash? A ka mundësi edhe 28 herë me u pre ajo rrugë? Kështu tash, ja po. Jo me ndreq, jo s'e ke ndreq! Rruga është e prishur. Po unë tash po kërkoj që edhe nja 28 herë me pre rrugën, bile të prishet kështu tamam. Megjithëse ajo është prishur edhe me një trotuar që e keni bërë tash, është mirë një komision me bë tash si drejtor i shërbimeve publike, edhe si ish-drejtor i Inspektoratit me shkuar me vlerësu se si është shkatërruar ajo rrugë. Drejtor, ajo rrugë është ndërtuar në kohën kur ka qenë kryetar i Prizrenit profesor doktor Eqrem Kryeziu. Ajo rrugë është punuar në mënyrën më profesionale sepse kemi participuar edhe ne si komunitet. I kemi ndenjtur si komision te koka operatorit që ka kryer punimet. Në mënyrë më profesionale është bërë. U shkatërrua tash në qeverisjen edhe ata brenda një vit e gjysmë që është shkatërruar. Mundesh me hip kerrit, me shku, edhe ato që u pre asfalti. Të kam thënë në mandatin e kaluar, ma ki borxh ti edhe Qel Lamaj, rregullimin e makinës mua personalisht. Se mu ka prishur për shkakun e juve, që e keni prerë rrugën pa nevojë. Kjo është si çështje. Ka dhe të tjera, po aty vazhdojmë, besoj që do të na i dëgjoni kërkesat edhe çështjet që do t'i ngrisin këtu në këtë kuvend. Ndoshta s'ju rritet mendja, se janë dhe të drejtuara që tash s'folet dy herë me ata. Tash kemi me pa kush jeni me të vërtetë, se tash e keni marrë mandatin e dytë edhe shohim se shkyet ajo maska e shumë drejtorëve. Po dhe shumë vetëve këtu. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit. Fjalën e ka Selman Sokoli. Ne të përgatitet Haziz Hodaj.

**Selman Sokolaj (LVV):** Faleminderit kryesues. Mbase më shumë për me sqaru për shkak se kohët e fundit është hudhë shumë në opinion si dezinformata. Rruga edhe drejtori është i ri pak si një ndihmës të vogël drejtor kështu se mandatin e kaluar kemi pasur ndryshe. Rruga ER 112 është rruga rajonale që është Landovicë, Gjonaj, Krajkë, Romaj, Kushni, ..... lidhet me rrugën magjistrale Prizren-Gjakovë. Është rrugë rajonale, ka kodin ER 112, është në menaxhim të Ministrisë së Infrastrukturës, Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Ajo është rrugë tashmë veç është në procedura tenderuese, e ka vlerën diku 2.9 milionë euro. Edhe njëra prej punëve që ka me u kryer atë është zgjerimi i urës te Mulliri i Kushninit. Ndërsa, për me sqaru' për opinionin për shkak se ka pasur shumë paqartësi edhe gjatë zgjedhjeve lokale edhe aktualisht. Ajo rrugë, kur fillon nga Gjonaj e deri në Gorozhup, është rrugë në kompetencë lokale. Unë dashta edhe përmes kuvendit me sqaru edhe banorët e Gjonajt, por edhe të gjithë ata që kanë interes, mundin me ju qasë dhe faqes së Ministrisë së Infrastrukturës, dhe aty është shumë lehtë të shohim, nuk ka nevojë me u bind nga askush, as nuk ka nevojë me i besu' askujt. Aty e shohim që rruga Gjonaj, Mazrek, Kujush, Planej, Gurozhup, është në menaxhim të komunës së Prizrenit dhe në këtë rast i kisha shfrytëzuar rastin me i bëj thirrje kryetarit të komunës, që me intervenuar në atë rrugë për shkak se është në gjendje të mjerueshme edhe Gjonaj si një fshat më i madhi i rajonit të Hasit andej po nga fshatrat më të mëdhaja të Prizrenit nuk e meriton këtë gjendje. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Fjalën e ka Haziz Hodaj.

**Haziz Hodaj (LDK):** Faleminderit kryesues, faleminderit Selmanit për sqarimin se kjo rruga Landovic, Kushnin ka qenë e parapame që në vitin 2021, po është hek prej pozicionit buxhetor në qeverinë e Kosovës, se për fat të mirë tash është një lajm fantastik, ky që na vihet tash në fillim të qeverisë së re, por shpresojmë që do të ketë një qeveri funksionale. Po unë e kërkova fjalën për diçka tjetër. Fatmirësisht nuk është aprovuar buxheti për vitin 2026 nga kuvendi i komunës së Prizrenit. Për mos me na u arsyetuar në fund drejtorët që ky buxhet ka qenë i vitit të kaluar dhe ne nuk kemi pasur qasje, po kërkoj që në këtë draft, unë nuk e di a ka draft, po të rishikohet, sado më shpejt që është e mundur ky buxhet dhe të na vijë në kuvend për ta debatuar, sepse ka shumë pozicione për t'u ndryshuar. Domethënë, sigurisht që këtu do ta kenë fjalën edhe drejtorët të rinj, edhe ne anëtarët e kuvendit që ta kemi një buxhet, që në fund mos të kemi arsyetime se jo valla, kemi pasur një buxhet të aprovuar nga legjislacioni i kaluar edhe ne nuk kemi mundur me aprovu. Kështu që le të jetë një buxhet i kapshëm, konkret, i realizueshëm më në fund. Faleminderit. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Fjalën e ka Sevil Kazas.

**Sevil Kazazi (YTHP):** Sayın Belediye Başkanı, Meclis Başkanı, Meclis Başkan Yardımcısı, Belediye Başkan Yardımcısı, değerli Müdürler öncelikle sizlere yeni görevlerinizi tebrik etmek istiyorum, çalışmalarınızda başarılar dilemek istiyorum; kıymetli Meclis üyeleri, medya mensupları ve değerli katılımcılar hepinizi saygıyla selamlıyorum. Çok fazla sorum olmayacak halkımızdan aldığım talepler ve şikâyetler doğrultusunda birkaç soru iletmek istiyorum. Öncelikle Kamu hizmetleri müdürlüğüne sorularım olacak; Halil Berisha caddesinde “Gjon Buzuku” lisesinin arkasında yapılan inşaat çalışmaları çevre evlerin duvarlarına zarar vermiş, resmi olarak şikâyetle bulunulmasına rağmen mahalle sakinleri henüz bir cevap almamıştır, şimdilik çalışmalar durmuş vaziyette, sebebini ve çalışmaların ne zaman devam edeceğini öğrenmek istiyorum! Diğer taraftan Shuaip Spahiu caddesinde küçük inanın olduğu bölgede trotuar diye bir şey kalmamış müdür bey, trotuarlardan araçlar park edildiği için özellikle yaşlı ve bebekli vatandaşlar yol ortasında yürümek zorunda kalıyor! Bu caddede bir an önce bağlantılı olduğu Shuaip Spahiu caddesindeki yol ve çevre çalışmalarının yapılmasını talep diyorum. Ortakol bölgesi ve Duşanova’da trafik ışıklarının olmaması gelen şikâyetler arasında, karanlıktan yaya geçitleri bile gözüküyor! Son olarak şehrin ortasından geçmesi yasaklanan otobüslerin en azından sabah saat 9’a kadar geçmesi talep ediliyor. Çünkü işçiler işlerine gitmek için önce otobüs istasyonuna kadar yürümek zorunda kalıyor, oradan otobüsle işlerine ulaşıyorlar, bu da hem zaman açısından hem de ulaşım açısından çalışanlara zorluk yaratıyor. Diğer taraftan Tarım müdürlüğüne bir sorum olacak: Geçen dönemde olduğu gibi bu dönem de sokak köpekleri şikâyetleri gelmeye devam ediyor, barınağın inşaatını biliyorum, vatandaşlarımıza da bildirdim ancak proje ne zaman tamamlanacak? Bunu öğrenmek istiyorum! Teşekkür ederim saygılarımla!

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit. Fjalën e ka Agim Muqaj.

**Agim Muqaj (AAK):** Faleminderit kryesues. Unë dëshiroj këtë ditë të sodit me fillim të mandatit t'ju uroj gjithë kuvendarëve shëndet dhe një punë të mbarë. Gjithashtu kryetarit dhe ekzekutivit të rinj, pasi që disa drejtorëve ndoshta janë dikush në pozitën e njëjtë dhe shumica janë të ndryshëm dhe sidomos atyre që janë drejtorët e rinj. Duke u nisur nga vërejtjet apo kërkesat të cilat kenë edhe pak ma herët për arsye të dëmeve natyrore, unë kisha dëshiruar që gjatë këtij mandati edhe kryetari, edhe gjithë ekzekutivi që të jemi më vigjilent si nëpër komisionet, ato që do të emërohen, projektet apo tenderët të cilat do të ofrohen në drejtoritë përkatëse, që të mbikëqyren sa më shumë dhe sa më mirë dhe të jenë më rigoroz në mbikëqyrjen e komisioneve përkatëse apo mbikëqyrja të çdo drejtorie, sepse e dimë që edhe në mandatin e kaluar, pavarësisht se ka pasur punime, po jemi dëshmitarë të çdo situatë, sepse ka shumë, shumë vend për t'u ankuar, sepse punimet nuk kanë qenë të mira në shumicën rasteve. Dhe në këtë rast, për dallim nga të gjitha drejtoritë, edhe zoti Ukimeri i dëshiroj punë të mbarë. E di që ke një drejtori e cila është shumë komplekse dhe ka dinamikë të punës më shumë se të gjitha drejtoritë. Kisha kërkuar që mbikëqyrësit e juaj të jenë shumë syçelë dhe mos të pranohen punimet të cilat veç i marrin të gjithë tenderuesit, sepse ka ankesa gjithandej të të gjithë qytetarëve sepse shumica e punimeve, mirret tenderi, por punimet asnjëherë nuk kryhen ashtu siç janë kriteret e përcaktuara. Kështu që, ju dëshiroj punë të mbarë, por edhe ne do të jemi vigjilent për çdo punë që do ta bëni. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit. Fjalën e ka Ilir Gashi.

**Ilir Gashi (LVV):** Faleminderit zoti kryesues. Urime dhe suksese për të gjithë të zgjedhurit dhe emëruarit në ekzekutiv. Uroj që angazhimi ynë në këtë legjislativ dhe ekzekutiv të jetë i dobishëm për komunitetin, për komunën ku jetojmë. Zoti kryesues, jemi në seancën e parë të rregullt dhe e kemi qartë se jemi në sallën e kuvendit, ku fjala është e kuvendarëve këtu dhe ekzekutivi është për t'u përgjigjur në pyetjet tona e jo për të dhënë direktiva se si duhet ta udhëheqim seancën tonë. Mos të bëjmë precedent. Çështja e dytë ka të bëjë me drejtorinë e shërbimeve publike. Drejtor, për katër vite, në këtë kuvend, jashtë kuvendit, ju kemi kritikuar për ndriçimin publik, në veçanti në lagjen Arbana dhe Jaglenicë. Te hyrja e ITP-së, nuk ka javë që nuk shkaktohen aksidente të përmasave të ndryshme. Para disa ditëve kishim edhe një aksident tjetër me lëndime të një personi. Ju lutem ndërmerrni masa në rregullimin e ndriçimit dhe sinjalistikës. Faleminderit për dëgjim.

**Karanfil Haxhillari (LVV):** Faleminderit. Përshëndetje për të gjithë. Urime anëtarëve të rinj emërimi sot në kuvend, në legjislaturën e re. Pa dashur me zgjatur shumë edhe unë i kam disa shqetësime dhe kërkesa të komunitetit në Prizren. Është bëhet fjala për rrugën Ajdin Rrahmanaj apo përkatësisht te pjesa që e lidh domethënë banesat e Euro Centrës që del poshtë në Tabakhane, ka gjashtë muaj aty që nuk funksionon ndriçimi. I njëjti rast është edhe në lagjen Petrov, ku kemi një ndriçim që është ndriçim i ri. Edhe unë besoj që firma, e cila e ka bërë atë ndriçim, hala e ka atë kontratën e garacionit që e mirëmban atë ndriçim për sa muaj ka, por që nuk ka zgjatë më shumë se gjashtë muaj ai ndriçim në Petrov, komplet lagjen në Petrov. Njëjtë është edhe një shqetësim tjetër i cili vjen nga lagja Bylbyldere ku me shirat e fundit është dëmtuar hyrja e kanalizimit të ujit të rrjedhjes së prockës aty dhe tashmë një shi i vogël aty po krijohet një katrahure vërtetë nëpër të gjitha shtëpitë e asaj lagje, ku futet uji. Prandaj kërkoj që të ndermirren masa, qoftë

nga shërbimet publike apo qoftë nga drejtoria për emergjencë, që ta funksionalizojnë rrjedhën e ujit, sepse nga lart, nga mali futet nëpër tërë lagjen dhe ajo pasojë krijon me të vërtetë një problem nga Bylylderja deri në tek gjimnazi poshtë. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit Karanfil. Fjalën e ka Petrit Hoxha.

**Petrit Hoxhaj (Guxo):** Faleminderit kryetari kryesues, i nderuar kryetar, të nderuar drejtor ekzekutiv, të nderuar kolegë kuvendar. Me seancën e parë filluan edhe shumë kolegë kuvendar për çështjen e rrugëve, ndërsa unë i nderuar drejtor i shërbimeve publike kërkoj që të bëhet një plan dhe një projekt për zgjidhjen e hyrjes dhe daljes në rrugën kryesore në fshatin Vljashne, po ashtu edhe hyrjen dhe daljen në fshatin Poslisht, sepse aty po krijohen kolonat të gjata dhe po pengojnë shumë qarkullimin e lirë në këtë rrugë. Përpos sezonës së verës që bëhet aty, do të thotë kolonë të gjata, ka filluar tash edhe jashtë sezonës së verës. Mirë është të formohet një ekip nga kjo drejtori dhe të dhe të shikohet mundësia për krijimin e ndonjë krah hyrëse apo dalës në këto vende, sepse ka me të vërtetë ka edhe të cilat po ndodhin shpesh, por fatmirësisht janë pa fatalitet. Si obligim edhe besoj që vazhdimisht në këtë vit do ta keni kërkesën e njëjtë për me pa, do të thotë, mundësinë e krijimit të një shiriti hyrës dhe dalës në këto dy fshatra. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit. Fjalën e ka Eldis Abazi

**Eldis Abazi (VAKAT):** Dëshiroj të drejtohem për problemin serioz lidhur me transportin publik në fshatin Grnçar, banorët e fshatit Grnçar katër muaj nuk kanë transport që e vështirëson jetën e përditshme. Posaçërisht theksoj që tenderi për këtë linjë është përfunduar dhe është shpallur më 15 dhjetor 2025, cila firmë e ka fituar kontratën por punimi nuk ka filluar ende. Nuk kanë qasje në shkolla, vende të punës, institucione shëndetësore dhe shërbime të tjera shërbyese. Një situatë e tillë është e papranueshme dhe kërkon intervenim të menjëhershëm të organeve përkatëse. E thirr drejtorin e shërbimeve publike ta rishqyrtojë këtë problematikë dhe të sigurohet transporti për banorët e fshatit Grnçar, është obligimi ynë të reagojmë kur qytetarët mbesin pa shërbime themelore dhe të sigurojmë të drejtat e barabarta për të gjithë banorët e komunës sonë. Dhe i falënderoj drejtorit të shërbimeve publike Islam Ukimeraj që ka reaguar për rrëshqitje të dheut në Zhup dhe Podgore.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Dafina Alishani e ka fjalën.

**Dafina Alishani (LVV):** Faleminderit kryesues. Meqë jemi në seancën e parë, unë ju dëshiroj të gjithë drejtorëve dhe drejtoreshave suksese edhe uroj që keni me pas bashkëpunim me legjislativin. Çelësi i bashkëpunimit është me u përgjigjur në pyetjet tona, qoftë këtu, qoftë me shkrim. Mandatin e kaluar nuk kemi pasur një eksperiencë të mirë. Unë po ju bëj lutje që nga fillimi që ta kemi një bashkëpunim. Ne i kemi punët tona, ju i keni punët e juaja edhe shpresojmë që së paku ta keni parasysh secilën kërkesë, nëse nuk mundet me u realizu së paku një sqarim apo një përgjigje, e meritojnë të gjithë këta këtu që janë të votuar. Po ashtu ju uroj edhe suksese kuvendarëve të rinj që u betuan sot. Edhe për fillim e kam një kërkesë prej kryetarit, prej kryesuesit, të cilën e kemi monitoruar edhe domethënë në mandatin e kaluar e që nuk është mirë për demokraci. Çështja, edhe

pse është shumë teknike, edhe po më vjen shumë keq që po e ngris këtë çështje, po është çështja e postimeve në faqen e komunës së Prizrenit. Domethënë, opozita si mos me qenë pjesë e kuvendit është në secilin postim të faqes zyrtare të komunës së Prizrenit. Nuk është mirë për memorien institucionale, edhe unë po ju bëj thirrje edhe juve kryetarë që t'i bëni thirrje stafit juaj, kabinetit juaj, që mos të eliminohet asnjë palë e legjislativit këtu, të cilët kanë ulëse dhe kanë arritur që ta marrin besimin e qytetarëve. Tash e mbas mos të kemi kësi ndasi, me pas vetëm fokusin në pozitë, edhe opozita është në kuvend, kështu që ju bëj thirrje, disa herë ju kam bërë thirrje, me start po ju bëj këtë kërkesë dhe këtë lutje që ta keni parasysh. Po ashtu, dua të di, domethënë këtu po e shoh që janë dy mungesa, nuk e di a po mungojnë drejtorët apo ende nuk kanë qenë të emëruar, edhe pyetja ime e parë për kryetarin është pse kemi kaq pak gra në ekzekutiv, a nuk paska gra zonja profesioniste të cilët mundën me u ulë këtu dhe me marrë përgjegjësinë. Juve grave që jeni të pakta, drejtoresha Lulijeta, Semra dhe Ajlin, ju uroj një bashkëpunim të mirë. Neve këtu grave na keni. Nëse doni me bashkëpunu, na keni. Nëse jo, ju e dini. Edhe çështja e subvencioneve të papaguara. Meqë është fillimi i vitit edhe shumë Ojq, shumë organizata, shumë klube sportive ende nuk kanë marrë pagesa. Subvencionet disa nuk janë lëshuar. A ka mundësi dikush me i informu këta qytetarë të cilët janë në pritje edhe sa duhet të presin për këto pagesa të cilët janë tej zgjatë vonesat e pagesave të tyre. Ju faleminderit e ju priftë e mbara.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Fjalën e ka Albulena Balaj Halimaj.

**Albulena Balaj Halimaj (Nisma):** Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, i nderuar kryesues, nënkryetar, drejtor, anëtar të kuvendit komunal në Prizren, meqë është seanca e parë e zakonshme dhe po diskutojmë në këtë pikë të rendit i ditës. Unë nuk është se do të doja të ngrisja çështje të ndryshme, të cilët vetë qytetarët na kanë dhënë mundësinë t'i paraqesim këtu, por po dua t'i uroj secilit anëtar të zgjedhur këtu, po i ftoj në bashkëpunim dhe po besoj që përveç që ose përtej përgjegjësive tona partiake, ne të kemi përgjegjësi për bashkëpunime, për interesa publike. Dhe asnjëherë për ato personale. Dua t'i uroj edhe kolegët të tjerë, të cilët sot u zgjedhën për herë të parë. I uroj suksese. Gjithashtu edhe drejtorët, punë të mbarë për ta edhe po besoj në bashkëpunim. Ajo që sot vërejta këtu është një debat konstruktiv që dua edhe uroj që të vazhdoj edhe në të ardhmen, por po dua që të them se në secilën pikë ose secilën kërkesë që anëtarët e kuvendit e shtrojnë këtu për futjen në rend të ditës ose heqjen, unë mendoj se duhet të vendoset në votim, pastaj anëtarët e kuvendit të vendosin nëse duhet të shtojnë ose të heqin, për shkak se kuvendi, kjo hapësirë, është një hapësirë në të cilën duhet të zhvillohet demokracia dhe jo të ngulfatet. Faleminderit shumë.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit Albulena. Ka diskutime të tjera? Pyetje të tjera? Jo. Kisha rekomanduar nga drejtorët që të gjitha pyetjet t'ia përcjellin me shkrim të gjithë kuvendarëve. Përgjigjet, përgjigjet pra t'i marrin me shkrim kuvendarët. Rekomandimi është i imi. Kryetar, keni ju përgjigje kryetar. Për shkak të kohës ju'a përcjellni me shkrim të gjitha përgjigjet në pyetjet të kuvendarëve. Urdhno Agim Muçaj.

**Agim Muqaj (AAK):** Unë mendoj se ndoshta në moment të caktuar me drejtorët nuk mund të japim përgjigje ndoshta në situata të caktuara, mirëpo këtu jemi për debat dhe kërkesat e tona dhe veprimet e tona ndonjëherë duhet t'i marrim drejtpërsëdrejti, mirëpo s'do të thotë që ndonjëherë nuk duhet të presim përgjigje me shkrim. Ama në shumicën e rasteve duhet të debatojmë, të japim vërejtjet tona, kërkesat e tona, mendoj se janë publike. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Arsyeja ishte e rekomandimit të drejtorëve, pasi që shumica e drejtorëve janë të rinj në pozitë, derisa të marrin informata në pyetjet e juaja, ata do t'i merrni të gjitha përgjigjet me shkrim. Besoj se të gjithë drejtorët do të jenë shumë korrekte dhe transparent në punën e tyre.

**Dafina Alishani (LVV):** Kryesues në emër të grupit të Lëvizjes Vetëvendosje, shpreh keqardhjen çfarë fillimi po kemi. Ju as nuk e vetët asnjë drejtor, a janë të gatshëm me u përgjigj? Ju ndërhyjnë në punë kryetari, edhe nëse janë të gjithë të rinj, kryetari është i vjetër bre!. Ishte dashur bile së paku një pyetje me na u përgjigjur kushdo që e ka ngritur si shqetësim. Nuk mundemi tash ne me prit këtu derisa t'ia nisim këta me marrë eksperiencë, ndërkohë qytetarët po kanë kërkesa. A di, nuk është korrekte kjo me start me fillu këtë qasje. Atëherë pse po vijmë ne këtu? Secili drejtor pak a shumë i dinë këto pyetje të cilat i kemi ngrit, të cilat ato që nuk i dinë secili asambleist e ka obligim me ja kthyer një përgjigje. Së paku me thënë, më fal, sot nuk jam i përgatitur ta kthej me shkrim. Po nuk mendoj që asnjë drejtor nuk ka asnjë informatë të cilët u ngrit, secili asambleist e ka prioritet kërkesën e qytetarit. Është tepër keq me fillu kështu!

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Dafina, rregullorja e kuvendit ja jep atë drejtën çdo drejtori që t'ju përgjigjet edhe me shkrim. Edhe pasi është seanca e parë dhe shumica e drejtorëve janë që dje dhe disa janë emëruar, unë ju rekomandova që të gjitha pyetjet që i keni parashtruar t'i merrni përgjigjet me shkrim. Do t'i merrni të gjitha përgjigjet.

**Dafina Alishani (LVV):** Ose ne nuk jemi në kuvend ose ju? Unë e pashë drejtoresha që e çoi dorën me u përgjigj. Nuk është mirë ju me fol në emër të ekzekutivit. Ju lutem secili le ta ketë përgjegjësinë në detyrën e vet. Kush nuk do me u përgjigj, deklarohet, edhe në rregull jemi e presim me shkrim.

**Karanfil Haxhillari (LVV):** Në fakt, asnjëri prej kuvendarëve nuk patë kërkesë për vete. Të gjithë i patëm kërkesat dhe ankesat e qytetarëve. Dhe kjo tregon Shaqir Totaj se çfarë qeverisje do me bë, dhe çfarë neglizhence ndaj kërkesave të thjeshta të qytetarëve. Nuk mundet kërkush me ja mohuar fjalën e pyetjes dhe përgjigjes drejtorëve, sepse shumë qytetarë po na shohin live direkt dhe po presin se çfarë përgjigje do të kenë nga ky ekzekutiv për fatin e tyre që po i shqetëson çdo ditë. Dhe ne, apo në këtë rast ju çfarë po bëni? Do t'ju përgjigjem me një shkrim. Mo! Kjo nuk është transparencë. Kjo definitivisht tregon shumë për qytetarët se çfarë qeverisje kanë me pasur për 4 vitet e ardhshme!

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Karanfil, rregullorja e kuvendit jep të drejtën çdo drejtori se si të përgjigjet. Nuk ja imponon ti, nuk ja imponon ju që a të përgjigjet në këtë seancë tash apo ta merrni

përgjigjen me shkrim. Drejtori është i obliguar me ta dhënë përgjigjen. Keni me i marrë përgjigjet me shkrim, i rekomandova edhe është seanca e parë. Do t'i merrni edhe përgjigjet edhe në kuvend. Kjo është! Rregulloren e punës nuk na përcakton neve se si të veprojmë. Edhe ty, edhe mua, edhe të gjithë drejtorëve. Rregullorja e punës së Kuvendit e kanë të drejtën që t'i merrni përgjigjet edhe me shkrim.

**Ilir Gashi (LVV):** Kryesues, me këtë logjikë atëherë i bjen që as nuk kemi nevojë për këtë rend të ditës. As nuk ka nevojë ekzekutivi me qenë këtu prezent. Me shkrim dërgojmë pyetjet tona, me shkrim marrim përgjigjet tona, edhe atëherë po humb funksionin ky Kuvend. Po humb edhe kuptimi i përfaqësimit. Ne jemi përfaqësues të popullit edhe ne i bartim çështjet dhe brengat e tyre direkt në kuvend, aty ku është vendi .. për me ngritja e çështjeve kuvendarëve. Dhe ti na privon tash me pas bashkëbisedim, me marrë përgjigje direkt prej ekzekutivit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Kisha kërkuar një përgjigje prej juve. A jemi brenda kornizës së rregullores së punës së kuvendit? Kur rregullorja e punës kuvendit ja lejon që të përgjigjen ta merrni edhe me shkrim.

**Adem Shabanaj (LVV):** Faleminderit kryesues. Nuk dashta me u kyç në këtë pikë të rendit të ditës, meqenëse ishte seanca e parë, edhe drejtorët sapo e kanë marrë detyrën. Nuk dashta me i ngarku me pyetje, me seancën e parë. Por gjithsesi, meqenëse u inkuadrova, i dëshiroj suksese ekzekutivit, drejtorëve, të cilët janë emëruar për këtë mandat. Gjithashtu i uroj suksese edhe kolegëve të cilët janë betuar sot në kuvend. Në veçanti drejtorit për punë dhe mirëqenie sociale, meqenëse mendoj që drejtoria që më e ndjeshme, në fakt është në komunën e Prizrenit, që ka të bëjë me ndihmat dhe me rastet sociale të qytetarëve të komunës i Prizrenit. Mendoj që ka qenë drejtoria që ka qaluar më së shumti në mandatin e kaluar dhe me eksperiencën e tij zotëri Memaj, besoj që do të punojë ndershëm dhe për të gjithë qytetarët e Prizrenit, pa përjashtim. Mohimi i të drejtës së fjalës së drejtorëve kryesues, nuk është e drejtë e as rregullores e as e punës së kuvendit. Tek e fundit kemi pasur diskutime edhe për edhe mandatet e kaluara për këtë pikë të rendit ditës, është e vetmja pikë ku edhe kuvendarët edhe ekzekutivi e bëjnë politikën e tyre dhe qëndrimet e subjekteve e tyre politike. Kërkesat e kuvendarëve mendoj që duhet të kthehet përgjigje, qoftë në seancë apo qoftë edhe me shkrim. Ne kemi pasur raste kur drejtorët nuk i kanë përgjigjet adekuate ose të sakta për të kthyer përgjigje, mirëpo jo çdo drejtor është ekspert i asaj lëmie e asaj fushe, por i ka edhe punëtorët të cilët janë në drejtoritë përkatëse dhe informacioni nga ta mund të sjellë edhe përgjigjen me shkrim, por asesi të mohohet fjala që të kthejnë përgjigje në seancën të kuvendit, sepse po e potencojë edhe njëherë, që kuvendi është, po mendoj që është vendi ku duhet të bëhet politikë, sepse politikisht jemi këtu. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit Adem. Fjalën e ka Selman Sokolaj.

**Selman Sokolaj (LVV):** Kryesues, fatkeqësisht kjo është mënyra më e keqe e mundshme që ju me vazhduar punën ose me fillu punën si kryesues i kuvendit komunal, për shkak se ju po tentoni me ndërtuar një precedent që ka me qenë shumë i dëmshëm në katër vitet e ardhshme. Çdo seancë

të ardhshme, secili drejtor këtu, në bazë të interpretimit juaj ka me pas mundësinë që nëse s'do me u përgjigjur, nëse zakonisht drejtorët nuk duan me u përgjigjur në pyetjet dhe çështjet e kuvendarëve, edhe ata kanë me na u drejtuar neve që sot s'kanë përgjigje. Rregullorja e punës së Kuvendit i obligon drejtorët me i dhënë llogari legjislativit. Kemi të bëjmë me ekzekutiv dhe legjislativ shumë qartë ndarje të pushteteve. Ata drejtorë që nuk kanë përgjigje të sakta, të detajuara, munden me dhënë përgjigje të përgjithshme, ndërsa detajet aty mund të me u deklaruar ata personalisht që na japin me shkrim. Herën e parë thatë për shkak të kohës, nuk e di çfarë koncepti kohës po përdorni ju, ju jeni kryesues i kuvendit komunal dhe jeni të detyruar këtu me qëndruar përderisa kryhen të gjitha pikat e rendit të ditës. Kjo është puna parësore juaj, nuk keni punë tjetër. Herën e dytë the, drejtorët janë të rinj, tash veç mundesh me thënë s'po dojmë edhe u kry. Edhe sinqerisht ky drejtori Ukimeri ka qenë katër vite në pozicion mbrojtës, më duket e padrejtë me ja mohuar tash se është në shërbime publike ku ka njeri çka tregon. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Mirë, atëherë marrim mendimin e drejtorëve. Unë ju rekomandova që përgjigjet t'jua përcjellin me shkrim. Tani drejtorët mund të përgjigjen çdonjëri. Atëherë përgjigjet do t'i merrni me shkrim.

**Haziz Hodaj (LDK):** Unë sinqerisht nuk po flas as si anëtar i kuvendit i që i përket koalicionit. Po po flas si anëtar i kuvendit edhe më i vjetër edhe po i kisha lutur anëtarët e kuvendit nga Lëvizja Vetëvendosje mos me na dhunu me të njëjtat fjalë, foli Dafina në emër të grupit, edhe shumë e qartë ke. Të njëjtat fjalë u përsëriten edhe nga katër anëtarë të kuvendit tjerë, po kjo është torturë për anëtarë të tjerë të kuvendit, pak mirëkuptim. Se absolutisht opozitarizmi le të jetë më i fortë i mundshëm, mirëpo të njëjtat fjalë, të njëjtat kërkesa, kjo vërtet është e tepërt.

**Dafina Alishani (LVV):** Emri mu ka përmendur edhe më duhet me ja kthi një përgjigje. Po, faleminderit Haziz, për mënyrën e opozitarizmit, unë mendoj që ju si LDK keni vendosur a jeni pozit apo opozit. Mënyrën e opozitarizmit të Lëvizjes Vetëvendosje po të lutna me ja lënë Lëvizjes Vetëvendosje. Ne i vendosim qysh flasim, sa veta flasim, edhe kush flet qysh flet. Sa i përket për, që ne po flasim gjëra të njëjta, po edhe ju bre zotni sendin e njëjtë e propozuat, ju kërkuat komision, ai tjetri propozoi prapë komision, ai tjetri tha mbështes Hazis Hodën, tash të jemi edhe ne, të njëjtat çështje i keni ngritur edhe ju, edhe tash Vetëvendosja koka problemi. A mund dhe ne opozitarizmin me ja lënë Vetëvendosjes? E dimë që ju nuk dini, lërnani neve. Faleminderit.

**Selman Sokolaj (LDK):** zoti Hodaj e ka pasur një status shumë qortues ndaj partisë së tij edhe ka dhënë tërheqje për shkak pakënaqësisë së emërimit të drejtorëve. Qenka shqetësuar shumë tash, po më duket si një lloj servili që me ju laritur pushtetit po e kritikon Vetëvendosjen. Më duket shumë e padrejtë. Kështu që, le të merret me pushtetin, me qëndrimet e tij a i ka ndryshuar, mirëpo mos tenton ta ri legjitimojë veten duke u marrë me Vetëvendosjen. Shumë sinqerisht kështu si kërkesë e kam ndaj tij.

**Haziz Hodaj (LDK):** T'i përgjigjuna se ky servilizmi si terminologji sillet kështu vërdallë në politikën Kosovare, po, të gjitha mundesh me i gjet tek unë, përveç servilizmit. Kështu që, qetë rri për këtë punë, hiç mos u mërzit, bëne opozitarizmin e ki përkrahjen maksimale timen.

**4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Kalojmë në pikën e katërt, shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa. Komiteti për Politikë dhe Financa, komiteti i përhershëm, që e themelon kuvendi si trup ndihmëse e saj, Komiteti për politikë dhe financa ka disa përgjegjësi, të cilat ia jep ligji për vetëqeverisjen lokale. Komiteti për Politikë dhe Financa në komunën e Prizrenit përbëhet nga nëntë (9) anëtarë të kuvendit, të kryesuar nga kryesuesi i kuvendit komunal. Paraprakisht, unë si kryesues kam mbajtur takim me shefat e grupeve. Dhe jemi dakorduar që së pari ta respektojmë kuotën gjinore edhe ndarjen e numrave të çdo që janë të përfaqësuara mbi tre e më tepër anëtarë të kuvendit të regjistruara në KQZ. Dhe jeni pajtuar të gjithë që të plotësohet kuota gjinore, që keni me shtuar diçka, mundeni, që nuk keni, atëherë fillojmë pra me shefat e grupeve duke i marrë propozimet e tyre. Atëherë fillojmë me Partinë Demokratike të Kosovës. Shefi i grupit pra Arianit Berisha.

**Arianit Berisha (PDK):** Përsëritje, të nderuar kolegë këngëtarë, i nderuar kryetar, të nderuar drejtor, meqë është hera e parë që po flas pasi e keni marrë pozitën, ju uroj suksese, punë të mbarë, llogaritni në mbështetje të tonën si kuvendarë për çdo punë të mirë në të mirë të qytetarëve, propozimi im pas konsultës me grupin tonë është që në komitetin për politikë dhe financa të jenë zonja Ymran Fusha, zonja Trëndelina Kastrati dhe unë Arianit Berisha. Faleminderit.

**Dafina Alishani (LVV):** Faleminderit kryesues. Së pari i falënderoj grupin që më ka zgjedhur si shefe e grupit. Edhe ne me qelës neve na takonin dy anëtarë, nëse s'gaboj. Unë si shefe e grupit jam pjesë e KPF-së, jam propozuar nga grupi si dhe Ilir Gashi.

**Qemal Krasniqi (LDK):** Grupi i kuvendarëve të LDK-së ka caktuar Haziz Hodaj dhe Agnesa Sinanaj.

**Liridona Veçisht (BDP):** Përsëritje kryesues, përsëritje kryetar, përsëritje të nderuar drejtor, të gjithë asamblesë, Bashkimit Demokratik propozon Shukri Qunin.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Ky ishte, kjo ishte përbërja pra. Ju falënderoj pra që keni gjetur një mirëkuptim që ta plotësojmë kuotën gjinore 50-50. Kalojmë pra, erdhëm në votim pra pikën e rendit të ditës me të gjithë këta të propozuar. 36 janë prezentë. Kush është për?

Unanimisht votohet kjo pikë. Ju faleminderit.

**5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Kalojmë në pikën e pestë. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të komitetit për komunitete. Edhe komiteti për komunitete është komitet i përhershëm që e thelon kuvendi dhe ligji për vetëqeverisje lokale i jep disa përgjegjësi të caktuara. Komiteti për komunitete, përbëhet nga anëtarët e kuvendit dhe përfaqësuesit e komunitetit jo shumicë që jetojnë në komunën e Prizrenit. Komuniteti jo shumicë duhet të jetë në këtë komunitet njëjtë pra kuota gjinore 50 me 50 sikurse te Komiteti për Politikë dhe Financa. Së pari dua t'ju sqaroj se të gjitha partitë ose subjektet politike që janë të përfaqësuara këtu në kuvend, duhet ta propozojnë nga një kandidat. Dhe ju kisha lutur që edhe këtu ta respektojmë pra kuotën gjinore. Kurse ata komitete, pakicë të cilat nuk janë të përfaqësuara, ne pra zyra ligjore ka kërkuar ka kërkuar të dhëna nga zyra për komunitete dhe janë sjellë emrat e tyre. Atëherë pra fillojmë emërimin e tyre. Fillojmë:

PDK – Drita Qenaj

LVV – Karanfil Haxhillari

LDK – Mimoza Memaj

BDP - Liridona Veçgishti

AAK – Nazife Kokollari

KDTP - Sevilya Igcı Hapçi

GUXO – Petrit Hoxhaj

NISMA - Albulena Balaj Halimaj

SDU - Dzenqis Saliji

VAKAT – Eldis Abazi

NDS – Zikreta Aliti

YTHP – Sevil Kazazi

Faleminderit pra për propozimet. Ju thashë në fillim që kemi edhe komunitete të cilët nuk janë të përfaqësuara komunitetet pakicë të cilët nuk janë të përfaqësuara në kuvend. Ata, zyra e komuniteteve të tyre i kanë sjellë emrat e tyre. Kemi komunitetin ashkali, Nuhi Morina, komuniteti romë kemi dy propozime, paraprakisht para se të fillojmë seancën, u konsultuam me shefat e grupeve parlamentare dhe u dakorduam që këta dy emra të shkojnë në votim se për cilin nga këta. Te komuniteti romë kemi Rexhep Shopa dhe Fatmir Menekshe, komuniteti egjiptian Erhan Kryeziu, Hysnije Berisha, komuniteti Goran është një pra Elvira Goran dhe komuniteti serb pra dy janë Tihomir Stojanovič dhe Jasmina Savic. Këto janë propozimet që kanë ardhur nga zyra për komunitete në kuvendin komunal. Pra pas bisedimeve që patëm me shefat e grupeve, u dakorduam që këto që janë nga dy propozime të hidhen në votim. Secili prej tyre merr vota më tepër, ai shkon në komitet për komunitete. Atëherë, e hedhim në votim pra, kemi nga komuniteti i rom dy propozime. Rexhep Shopa dhe Fatmir Menekshe. Po, Dafina?

**Dafina Alishani (LVV):** Kryesues, këta a kanë ndonjë CV të cilët e kanë prezantuar tek ju, po së paku me na lexuar kuvendarëve, se po unë po shoh që shumica nuk po i njohin. Mos të bëjmë tash ndonjë gabim në emër të komunitetit? Ose nëse janë këtu le të dalin, le të prezantohen.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Dafina, këta përfaqësues kanë marrë nënshkrimet nga komunitete e tyre. Kanë qenë formularët, kemi marrë, kemi kërkuar nga zyra për komunitete. Ata kanë mbajtur takime me përfaqësuesit e tyre dhe ja kanë dhënë pëlqimin, e kanë dorëzuar në zyrën e komuniteteve, është protokolluar dhe ka ardhur shkresa te ne. Edhe unë nuk i njoh se kush janë, po nënshkrimet e tyre edhe komuniteti që i ka që i ka qar emrat e tyre, ata i njohin. Dhe ne bazën ligjore pra për mos të shkojmë nga ajo që jo janë dy edhe, ju thashë edhe më herët, ne mund të shohim edhe numrin e nënshkrimeve, patëm disa me një numër të madh të nënshkrimeve të tyre, disa me një numër të vogël të nënshkrimeve. Po thatë që më transparente do të jetë që ta hedhim në kuvend votimin e këtyre. Po Albulena.

**Albulena Balaj Halimaj (Nisma):** Nëse ka mundësi kryesues të paktën me ditë cili prej këtyre ka nënshkrime më shumë që ne me votu, për shkak se nuk po i njohim.

**Haziz Hodaj (LDK):** Jo, kryesues. Edhe unë e pata të njëjtin propozim si Albulena. Ai që ka nënshkrime më shumë ai le të zgjidhet edhe nuk kemi ne çka me votuar këtu. Janë të propozuar prej komuniteteve të veta, ai që ka më shumë nënshkrime shkon.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Mirë. Atëherë pajtohuni me fjalimin e Hazizit? Ai që ka nënshkrime pra ai shkon pra. Se kemi një rast që është me 8 nënshkrime dhe rasti tjetër është me 43 nënshkrime. Është një gjë që është e vështirë. Fatmir Menekshe ka 42 nënshkrime pra ka nënshkrime më tepër edhe ti o Tihomir Stojanoviç ka 49 nënshkrime kurse Jasmina Savic ka 8 nënshkrime. Atëherë mos të krijojmë shumë debat. E hedhim në votim. Sa jeni për ata që kanë më tepër nënshkrime që të shkojnë në komunitet për komunitete nga komuniteti pakicë, të cilët nuk janë të përfaqësuar këtu në kuvend. Kush është për?....

**Dafina Alishani (LVV):** Më fal kryesues, a shkruan dikë që nëse i ke nënshkrimet më shumë e ke të drejtën me qenë në komision? A është kriter? Po pse ani po e futni në rend të ditës. Me emra le të votohet, kushdo që e njeh le t'i voton. A ka kriter, a ka kriter që dikush hyn në komision nëse ka nënshkrime më shumë?

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Në qoftë se i ka marrë prej komunitetit të vet 49 nënshkrime, edhe personi tjetër nga po ai komuniteti ka marrë 8 nënshkrime, ndoshta ai është i filtruar në komunitetin e vetë edhe i ka marrë 49 nënshkrime. Ne tash qysh t'ia bëjmë të padrejtë atij, ta votojmë atë me 8 nënshkrime, ai me 49 nënshkrime mos të jetë anëtar i komitetit për komunitete.

**Dafina Alishani (LVV):** Për besë padrejtësia më e madhe është me votu njerin pa e njoftë e pa ja ditë asnjë CV. As nuk e di çka bën, tek bën. Është gabim me pru anëtarë të komisionit pa CV. Kjo është lëshim teknik. Nëse jemi tash vetëm me nënshkrime, kuvendarët po dojnë me ditë për kënd kanë me votu. Saktë, kjo është.

**Selman Sokolaj (LVV):** Edhe një sqarim? Dy serbët e propozuar, a është ndonjëri nga tyre i propozuar nga lista serbe? A mundem me ditë? Na trego? Na tregon kë përfaqësojnë ata se ne nuk mund, këtu për shembull, nuk mundem me votu të paktën unë personalisht përfaqësues të listës serbe. Kështu që, na tregon për kë po votojmë edhe si të votojmë.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Ata e përfaqësojnë komunitetin e tyre që është këtu. Ne e kemi jemi konsultuar me zyrën për komunitete edhe më tepër ata i kanë marrë pëlqimet nga ai komunitet ku gravitojnë aty edhe besoj që kjo praktikë, jo që vetëm në këtë legjislaturë, por edhe në legjislaturat e kaluara ka shkuar e njëjta, në bazë të nënshkrimeve janë votuar në kuvend edhe ata persona pra kanë vazhduar punën në komitet për komunitete. Atëherë, a pajtoni që në bazë të nënshkrimeve pra ta hedhim në votim? Cili ka nënshkrime prej këtyre dy komuniteteve më tepër, ai shkon. E hedhim votim pra në bazë të nënshkrimeve. Kush është për? 22 për. Kundër 8. Abstenim 2. E qesim në tërësi pra të gjithë përbërjen e cila komiteti për komunitete do t'i ketë gjithsej 17 anëtarë dhe në këtë komitet për komunitete numri më i madh pra jetë nga komunitetet pakicë. E hudhim në votim. Kush është për? 39 janë prezent.

**Dafina Alishani (LVV):** A mundeni me lexu emrat për kënd po votojmë se nuk po dimë? Jo bre se s'i lexoj. Përbërja e komitetit për komunitete është?

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Dafin, përbërja e komitetit për komunitete është të gjitha partitë të cilat janë të përfaqësuara në kuvend dhe ata komunitete pakicë të cilat nuk janë të përfaqësuara në kuvend. Nga komunitetet pakicë, të cilat nuk janë të përfaqësuara në kuvend është:

Nuhi Morina, nga komuniteti ashkali,  
Fatmir Menekshe, nga komuniteti rom,  
Erhan Kryeziu, nga komuniteti egjiptian,  
Elvira Goran, nga komuniteti goran,  
Tihomir Stojanovič, nga komuniteti serb.

Këta janë emrat që edhe së bashku me emrat e anëtarëve të kuvendit. E hedhim në votim.

**Dafina Alishani (LVV):** Ne si lëvizje nuk marrim pjesë në këtë votim sepse mendojmë që është padrejtësi me ja caktu kriterin e nënshkrimit sepse nuk ka të shkruar askund që nënshkrimi ty ta jep të drejtën e pjesëmarrjes ose të përbërjes në komunitet. Është kjo padrejtësi për komunitete. Shumë mbrapsht keni filluar si qeverisje. Le ta shoh komunitetet se qysh qeveris kjo qeverisje. Kaq.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** E hedhim në votim komitetin për komunitete. 39 janë prezent.

Kush është:

Për? 25

Kundër? 0

Abstenim? 0

Atëherë miratohet pika pra e rendit të ditës.

**6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete;**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Vazhdojmë me pikën e gjashtë, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për emërimin e nënkryetarit të komunës për komunitete. Për këtë pikë ja japim fjalën kryetarit të komunës.

**Shaqir Totaj (Kryetar i Komunës):** Të nderuar të pranishëm, unë dua ta propozoj zotin Furkan Bütuçi për nënkryetar të komuniteteve. Dhe ju ftoj që të votoni.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit kryetar. Po Sevil.

**Sevil Kazazi (YTHP):** Sayın Belediye Başkanı, Meclis Başkanı, Meclis Başkan Yardımcısı, Belediye Başkan Yardımcısı, değerli Müdürler, meclis üyeleri, değerli katılımcılar, medya mensupları, bizleri izleyen halkımız hepimizi saygıyla selamlıyorum. 2013 yılından bu yana bu salonda çeşitli görevlerle halkımızı temsil ederken her zaman adil, şeffaf, dürüst bir siyaset yürütmek adına elimden gelen hizmeti özveriyle sunmaya çalıştım. Bugün 4. Dönem Prizren belediye meclisinde halkımızın sesi olmaya devam etmekteyim. Bildiğiniz üzere Yerel Yönetim Yasası uyarınca geçen üç dönemde topluluklardan sorumlu belediye başkan yardımcılığı görevi Boşnak topluluğuna aitti. Mecliste görev aldığım 2 dönem boyunca bu görev Boşnak topluluğuna verildi. Ancak Türk toplumunun temsilcileri olarak yerel yönetim yasasına bağlı alt yönetmenliğin değişmesi ve Türk toplumunun da bu haktan yararlanması için yıllarca çaba sarf ettik. Geçen dönem yine ondan önceki dönemlerde olduğu gibi yerel yönetim idari talimatı henüz değişmediği için bu göreve Türk aday verilemiyordu, dolayısıyla Boşnak aday verilmişti. Maalesef bu oylamada üzerime çeşitli oyunlar oynanmış, karalama politikaları ile suçlamalar ve saldırılar yapılmıştı. Ancak geçen döneme kadar Türk toplumu olarak bizler bu haktan yararlanamıyorduk. Sorun benim oylamam değil, sorun idari talimatın değişmemesiydi! Kısa bir süre içerisinde idari talimatın değişmesiyle artık Türk toplumu da bu görevden yararlanabilecek ve bugün belediye meclisinde Prizren belediye başkanının önereceği Türk adayı yürekten ve iyi niyetimle destekleyeceğimi sizlere sunmaktan memnuniyet duyuyorum. Bizler ayrıştırıcı değil, birleştirici, yıkıcı değil, yapıcı, bölücü değil toplumsal bilinçle haklarımızı savunmaya ve korumaya devam edeceğiz. Teşekkür ediyorum saygılarımı sunuyorum.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Po, Eldis Abazi.

**Eldis Abazi (VAKAT):** Dëshiroj të qartësohem lidhur me këtë që jam thirrur edhe unë edhe Cengizi nga ana e Zikreta Haliti lidhur me nënkryetarin për komunitete në komunën e Prizrenit. Unë dëshiroj t'i shpjegoj komunitetit boshnjak që mos të krijohet konfuzioni lidhur me Udhëzimin Administrativ që ka qenë 2020 më 25 shtator ku neni 8 pika 3 ka shkruar ku zëvendës kryetari emërohet nga radhët e komuniteteve cila me numër është më e madhe në komuna. Ku tash në

Qeverinë e kaluar të Republikës së Kosovës 2023 në muajin dhjetor ky Udhëzim Administrativ ndryshohet dhe kjo pika numër 3 nuk qëndron në këtë Udhëzim Administrativ ku qëndron që kjo pozitë i takon komunitetit më të madh. Unë personalisht e kam kërkuar asambleisten që të merremi vesh lidhur me këtë pozitë, kemi kërkuar mbështetje, nuk ka dëshiruar të mbështesë kandidatin nga koalicioni VAKAT, dhe ne kemi kërkuar kandidatin e saj dhe nuk ka dhënë ndonjë emër lidhur me nënkryetarin për komunitete, dhe dëshiroj të më përgjigjet pse ka ardhur deri te ndryshimi i këtij Udhëzimi Administrativ. Ne kemi pasur pozitën e lartë si komuniteti boshnjak në Qeverinë e Republikës së Kosovës, pse nuk ka pasur reagime nga zëvendës kryeministrja dhe të drejtat e njeriut. Gjithashtu, në këtë ministri për pushtetin lokal ne kemi pasur zëvendës ministër nga partia nga e cila vjen Zikreta Haliti, ku nuk kanë reaguuar. A ka qenë lëshim, mosdija ose çka? Ata janë përgjegjës duke ditur që ishin në këto pozita në qeverinë e kaluar. Nuk kanë guxuar të lejojnë që të bëhen ndryshime, tash me daljen nga kuvendi i komunës së Prizrenit nuk është zgjidhja që të mbrohet kjo situatë dmth, zgjedhja e nënkryetarit për komunitete dhe ka lejuar komunitetin turk duke ditur si zgjidhet zgjedhja e kryetarit me numrin shumicë e komuniteteve dhe shumicën absolute në kuvendin komunal Prizren. Ne nuk kemi mundur të bëjmë marrëveshje sa i përket komunitetit boshnjak dhe asambleistëve, gjithashtu pa pas mosmarrëveshjet mes koalicionit Vakat dhe SDU dhe s'kemi mundur të japim emrin e kandidatit për nënkryetar. Me këtë rast dëshiroj të them që në mandatin e kaluar kemi qenë shumë të anashkaluar si komunitet dhe nuk kemi pasur nënkryetarin për shkak të kësaj situatë dhe nuk kemi pasur as drejtor në ekzekutiv, ka ardhur drejtor pas kalimit të gjysmës së mandatit. Këtë herë ne si komuniteti boshnjak kemi menduar ndryshe, i falënderohem kryetarit të komunës z. Totaj që ka mundësuar komunitetin boshnjak me qenë pjesë e ekzekutivit dhe këtë herë kemi 2 drejtorë: drejtorin për situata emergjente dhe drejtorin e inspektoratit. Faleminderit.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Atëherë, sipas udhëzimit administrativ të MAPL-së numër 03/2023, për procedurën e emërimit të nënkryetarit nga komunitetet, parashihet votimi dyfishtë, ku njëherë duhet të votojë i gjithë kuvendi dhe pastaj komunitetet jo shumicë. Jo, ka ndërruar udhëzimin administrativ, këtu e kemi edhe udhëzimin administrativ. Atëherë, 39 konstatojmë se janë në sallë. Po, Ilir Gashi e ka fjalën.

**Ilir Gashi (LVV):** Faleminderit kryesues, në emër të grupit asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, zotëri Furkan Bytyqi edhe përkundër faktit që kemi pasur një përvojë të hidhur me ju, në mbrëmje keni pasur fjalë të tjera, e ditën keni bërë veprime të tjera. Në shenjë respekti që Lëvizja Vetëvendosje ka për të gjitha komunitetet, në veçanti për komunitetin turk dhe për faktin që mandatin e kaluar kryetari Totaj nuk ka marrë asnjë veprim për emërimin dhe votimin e nënkryetarit për komunitete. Lëvizja Vetëvendosje do të votojë për Furkan Bytyqin si nënkryetar për komunitete.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit Ilir. A ka dikush ta merr fjalën? A do dikush ta merr fjalën? Jo. Atëherë konstatojmë se në sallë jemi 39 kuvendar. E hedhim në votim pra propozimin e nënkryetarit për komunitete zotin Furkan Butuçi.

Kush është:  
Për? - 36  
Kundër? - 0  
Abstenim?- 1

Votohet nga komuniteti pakicë. Gjithsej në sallë janë pesë (5) anëtarë.

Kush është:  
Për? – 5 (unanimisht)  
Kundër? – 0  
Abstenim? - 0

Unanimisht votohet nga pesë (5) anëtarë, zoti Furkan Butuçi, nënkryetar i komunës për komunitete. Ju urojmë suksese dhe punë të mbarë.

Ja japim fjalën pra nënkryetarit për komunitete. Për ju pra mikrofoni, zoti nënkryetar.

**Furkan Butuci (Nënkryetar i komunës për Komunitete):** Sayın Belediye Başkanı Shaqir Totaj, Meclis Başkanımız, Belediye Başkanı Yardımcımız, Müdürlerimiz, Meclis üyelerimiz, değerli medya mensuplarımız ve ekranı başında değerli Prizrenli hemşerilerimiz, herkesi saygıyla selamlıyorum. İlk başta Boşnak ve Türk meclis üyelerimize ve bütün meclis üyelerimize desteklerinden dolayı teşekkür ediyorum. Bugün burada 13 yıl sonra Türk toplumunun bir mensubu olarak belediye başkan yardımcısı olmaktan, bu meclisten olmaktan gurur duyduğumu, mutluluk duyduğumu ifade etmek isterim. Bundan sonra sadece kendi toplumumuzun değil bütün Prizrenli hemşerilerimizin hizmetinde olduğumuzu buradan bildirmek istiyorum. Bu 4 yıl boyunca Belediye Başkanı sn. Shaqir Totaj ve meclis üyelerimizle, müdürlerimizle, Boşnak meclis üyelerimizle, kardeşlerimizle, Rom, Aşkali, Goran, Mısırlı bütün hemşerilerimizle, kardeşlerimizle beraber çalışacağımızı buradan bildirmek istiyorum. Biz bu toplumun bir mensubu olarak bu Prizrene daha güzel projeler, daha güzel Prizren için buradayız, biz birleştirici olarak buradayız, hem şahısım adına, hem partim adına Prizrene ne gerekiyorsa, her taşın altına elimizi koyacağımızdan, çekinmeyeceğimizden buradan istiyorum. Meclisimizi ve Prizrenli hemşerilerimizi saygıyla selamlıyorum.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Faleminderit nënkryetar. Dua t'ju informoj që pas marrjes së vendimit nga MAPL-ja për zgjedhjen e nënkryetarit, në seancën e radhës do ta zgjedhim edhe zëvendëskryesuesen të kuvendit.

**7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2026.**

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Fillojmë me pikën e shtatë, pra pikën e fundit për sot. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës së Prizrenit për vitin 2026. Ky grup punues ka për detyrë të hartojë planin e punës së kuvendit për vitin 2026, dhe në të njëjtin dhe të njëjtin plan ta sjell pra, po sa të përfundoj

draftin final këtu në kuvend. Sipas praktikave të mëhershme, në grupin punues të planit të punës, nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në kuvend, kanë qenë të përfaqësuara nga një anëtar. Atëherë, kemi diskutim, do ta merr fjalën dikush këtu? Atëherë, fillojmë pra me partinë më të madhe, pra PDK-së, që ta jepni emër në planin punues të si në grupin punues të planit të punës së kuvendit për vitin 2026. Po Adrit?

**Adrit Krasniqi (PDK):** Faleminderit i nderuar kryesues. Nga praktikat e mëhershme shefat e grupeve kanë shkuar ex-ofis në këtë komision, plus është propozuar nga një anëtar nga partitë politike.

**Simir Krasniqi (Kryesues):** Ndoshta mos, se edhe dy partitë që janë shtuar këtu mos po bëhet numri shumë i madh, mund të jetë puna më e vogël aty në planin e punës të kuvendit. Si ta shihni të arsyeshme, mundeni edhe ta zvogëloni numrin është e drejta e juaj si kuvendar, Adrit.

Vazhdojmë:

Simir Krasniqi, Kryesues i Kuvendit;  
Endrit Zogaj, propozohet nga PDK;  
Karanfil Haxhillari, propozohet nga LVV;  
Haziz Hodaj, propozohet nga LDK;  
Sefidin Islamaj, propozohet nga BDP;  
Agim Muqaj, propozohet nga AAK;  
Sevilya Igci Hapçi, propozohet nga KDTP;  
Albulena Balaj Halimaj, propozohet nga NISMA;  
Petrit Hoxhaj, propozohet nga GUXO;  
Zikreta Aliti, propozohet nga NDS;  
Eldis Abazi, propozohet nga VAKAT ;  
Dzengis Saliji, propozohet nga SDU dhe  
Sevil Kazaz, propozohet nga YTHP.

Faleminderit për propozimet. 37 janë të pranishëm. E hedhim në votim.

Për? – 37 Unanimisht votohet.

Ju uroj punë të mbarë. E mbyllim këtë seancën. Ju faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje dhe shihemi në seancën e radhës.

Mbledhja përfundoi në ora: 12:00

[https://www.youtube.com/watch?v=db9u\\_lcUk6Q](https://www.youtube.com/watch?v=db9u_lcUk6Q)



Kryesuesi i Kuvendit  
Simir Krasniqi